# DËSHMI ARKIVI

**A-442556**

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

VERSIONI 1

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | CDU fiton zgjedhjet komunale në Saksoninë e Poshtme |
| ADRESA | `https://www.cna.al/kosova-bota/cdu-fiton-zgjedhjet-komunale-ne-saksonine-e-poshtme-i474090` |
| BURIMI | cna.al |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 14 shtator 2026, 09:29:27 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 14 shtator 2026, 09:23:00 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `88bbbecfb9e2b647d1dc6354223682362363812bc6853c10713c0445d44fc510` |
| TEKSTI | `060f8b65590cbb95755ac12019fa23ad2c0b99e29800b93d375ab14f49e70a8d` |
| PAMJA | `34cce8fa858a23d45d3babc685cef44afced9b3a565db97153fa6a06b0b7f052` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `43905c9399de7046028cbedcb38342ee3c1cf48a9389bed6daa99292b75d4072` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `e4ff47e3158deeff08239dfd88de708dba9085a414711b421c21bd29dcd303ca` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/43905c9399de7046028cbedcb38342ee3c1cf48a9389bed6daa99292b75d4072`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

English

### E fundit!

x

11:13 Aktualitet

Ky titull është thelbi i përgjigjes që pritet të merret ng...

# CDU fiton zgjedhjet komunale në Saksoninë e Poshtme

14 Shtator 2026, 11:23, Kosova & Bota CNA



Mes debateve rreth kancelarit federal Friedrich Merz, pas humbjes në landin Saksoni-Anhalt, CDU-ja është bërë forca më e madhe politike në zgjedhjet komunale të landit të Saksonisë së Poshtme (Niedersachsen). Në nivel qarqesh, ajo arriti në 27,2 për qind të votave. Sipas rezultatit paraprak të publikuar në portalin zgjedhor të landit, SPD-ja mori 24,6 për qind.

AfD-ja shënoi rritje dhe arriti në 15,9 për qind. Të Gjelbrit morën 14,1 për qind, E Majta (Die Linke) 6,0 për qind, ndërsa FDP-ja 3,7 për qind.

Pjesëmarrje e lartë në zgjedhje

Në zgjedhjet e mëparshme për qarqet, të mbajtura në vitin 2021, CDU-ja kishte dalë forca më e madhe me 31,7 për qind, e ndjekur nga SPD-ja me 30,0 për qind. Të Gjelbrit kishin

arritur 15,9 për qind, FDP-ja 6,5 për qind, AfD-ja 4,6 për qind, ndërsa E Majta (Die Linke) 2,8 për qind. Rritjen më të madhe e ka shënuar AfD-ja, duke arritur rezultatin më të mirë ndonjëherë në zgjedhjet komunale në Saksoninë e Poshtme. Ndërkohë, CDU-ja dhe SPD-ja kanë humbur mbështetje krahasuar me zgjedhjet e mëparshme.

Pjesëmarrja në votime arriti në 64,6 për qind, duke shënuar një rritje të konsiderueshme. Pesë vjet më parë kishin votuar 57,0 për qind e qytetarëve me të drejtë vote. Këtë herë, rreth 6,3 milionë persona kishin të drejtën të merrnin pjesë në zgjedhje.

"Kemi vënë re pakënaqësinë ndaj Berlinit"

Kryetari i CDU-së në Saksoninë e Poshtme, Sebastian Lechner, u shpreh optimist që disa orë para publikimit të projeksioneve të para se partia e tij do të dilte forca më e madhe në rang të landit. Ai tha se ishte i bindur se CDU-ja e landit mund të shkëputej nga tendenca negative në nivel federal dhe se kishte një shans shumë të mirë të bëhej sërish forca kryesore politike në Saksoninë e Poshtme. "Ju e dini se këto zgjedhje komunale nuk janë zhvilluar në rrethana të lehta. Edhe ne e kemi vënë re pakënaqësinë ndaj Berlinit", tha Lechner, duke iu referuar klimës politike në nivel federal. Kryetari i SPD-së në Saksoninë e Poshtme dhe njëherazi kryeministri i landit, Olaf Lies, e cilësoi rezultatin e zgjedhjeve si të vështirë për partinë e tij: "Kishim shpresuar të gjithë për më shumë se kaq." Me këtë deklaratë, Lies pranoi zhgënjimin brenda SPD-së për rezultatin e arritur në zgjedhjet komunale./DW









Të sugjeruara

PDK-ja i kërkon Kushtetueses të vendosë masë të përkohshme për konstituimin e Kuvendit

Pas krizës në Ceuta/ BE, drejt ashpërsimit të politikave të emigracionit

Djegia e tragetit në Filipine/ Mund të duhen muaj për të identifikuar viktimat

Zgjedhjet në Suedi/ Blloku i krahut të majtë në avantazh

Rusia godet trenin ukrainas pak pasi Boris Johnson dhe zyrtarët e lartë evropianë largohen nga stacioni

Atmosfera politike para zgjedhjeve në dy lande gjermane

Bota shumëpolare, synimi strategjik i Kinës

Kanadaja planifikon të bëhet anëtare e asociuar e BE-së

Sulme me dronë rusë në kufi/ Evakuohet treni ku udhëtonte Boris Johnson dhe një këshilltar i Merz-it

Kurti: Asnjë gjykatë vendore e ndërkombëtare s'mund ta njollosë UÇK-në

Qeveria e re e Kosovës/ Zbardhen emrat e kabinetit të Kurtit

Votohet qeveria e re e Kosovës, Albin Kurti rizgjidhet kryeministër

Kurti shpalos programin dhe kabinetin e propozuar të qeverisë së re

## Kazakistani hedh hapin e parë drejt taksive ajrore

## Haxhiu mandaton Kurtin për formimin e Qeverisë/ Thirret seanca

## EMRI/ Lëvizja Vetëvendosje propozon kandidatin për Kryeministër

## Lufta në Ukrainë/ Rusia sulmon Kievin me mbi 450 dronë

## Vijojnë përplasjet në Ngushticën e Hormuzit/ Anija goditet nga predha

## Konstituohet Kuvendi i Kosovës/ Zgjidhen nënkryetarët

## Sot seanca konstituive e Kuvendit të Kosovës/ Çarë pritet të ndodhë

editorial

09:41 Editorial

**Drejtësia shqiptare dhe katër të vërtetat që askush s'i thotë bashkë**

**CNA LIVESTREAM**




Na ndiqni edhe në

- 
- 
- 
- 

acromax

19:53 Acromax / Aldor Nini

**Skandali- dokumenti/ Acromax i Aldor Ninit raportoi CNA duke abuzuar me RTSH**

opinion

09:30 Opinione Ardi Stefa

**Jo kundër Muzeut Hebraik në Vlorë, por kundër histerisë rreth tij**

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.